



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARNOLD HAJRO
ADRESA Blvd. "Gjergj Fishta", P.
Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë
TEL: 0692045569

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 419

Nr. koleksioni: 326

Tirane më 19/11/2025



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2025053970035254526



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
(U aplikua pulla e taksës)



A2025053970035254526

NR. REP. 419
NR. KOL. 326

KONTRATË SHITJE

- PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI) -

Sot, më datën **19.11.2025** (dymijë e njëzet e pesë) paradite, në Tiranë, para meje noterit Arnold HAJRO, me seli në adresën: Blvd. "Gjergj Fishta", Pall. Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë, u paraqitën personalisht palët kontraktuese:

• **SHITËS:**

Z. Adrian HAJRO, atësia Viktor, amësia Teuta, lindur në Tiranë, me dtl. 15-07-1966, me adresë: Nj. Bashkiake Nr. 5, Rr. "Ymer Kurti", P. 7, Sh. 1, Ap. 2, Tiranë; i martuar, shtetësi shqiptare, me Letërnjoftim ID nr. 036917921-G60715240M.

• **BLERËS:**

Z. Edmond DAKO, atësia Ilia, amësia Llambrini, lindur në Durrës, me dtl. 31-10-1962, me adresë: Rr. "Aleksandër Goga", Nd. 24, H. 1, Durrës; i martuar, shtetësi shqiptare, me Letërnjoftim ID nr. 034133645-G21031046F.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura (persona madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar), të njohur personalisht prej meje, unë, noteri, konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët në këtë marrëveshje, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të RSH, K.P. Civile, si dhe të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, hartojnë këtë kontratë, sipas kushteve të mëposhtme:

KUSHTE PARAPRAKE

- Shitësi në këtë kontratë, është ortak i vetëm i subjektit me të dhëna identifikues si më poshtë vijon:
Shoqëria "DOMUS GROUP AL" SHPK, person juridik shqiptar, regjistruar ne QKB, me NUIS: M21314026T, me seli ligjore në adresën: Nj. Administrative Nr. 5, Rr. "Pjetër Bogdani", P. 39/1, Ap. 3/7, Tiranë.
- Ortaku i vetëm **Z. Adrian HAJRO** ka në pronësi 1 (një) kuotë të kapitalit në vlerën ALL 100.000 (NJËQIND MIJË LEKË) me pjesëmarrje 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë.
- Sipas Ekstraktit të QKB mbi kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë, nuk rezulton ndonjë barrë siguroese.

NENI 1 - OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate është transferimi i pronësisë nëpërmjet shitjes i 49 % të kuotës së kapitalit që zotëron ortak i vetëm **Z. Adrian HAJRO**, në favor të blerësit **Edmond DAKO**.



Adrian Hajro
Edmond Dako
Studio Noteriale - Arnold Hajro
ADRESA : Blvd. "Gjergj Fishta", Pall. Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë, SHQIPËRI
Mob: +355 69 20 45 569; e-mail: hajro_arnold@yahoo.com

NENI 2 - ÇMIMI I BLERJES



A2025053970035254526

1. Shitësi – Z. Adrian HAJRO bie dakord t'i shesë dhe t'i transferojë 49% të kuotës së vet në favor të Blerësit – dhe ky i fundit pranon të blejë nga Shitësi duke paguar një çmim prej ALL 49.000 (DYZETENËNTË MIJË LEKË).
2. Në këtë mënyrë, me transferimin e pronësisë të kuotës me vlerë 49% (dyzet e nëntë për qind) të kapitalit, Shoqëria "DOMUS GROUP AL" SHPK do të ketë ortakë të saj Z. Adrian HAJRO që do të ketë në pronësi një kuotë me vlerë 51% të kapitalit dhe Z. Edmond DAKO që do të ketë në pronësi një kuotë me vlerë 49% të kapitalit.
3. Ortakët e shoqërisë konfirmojnë gjithashtu unanimisht se Z. Adrian HAJRO, do të mbajë njëkohësisht edhe funksionin e Administratorit të Shoqërisë.

NENI 3 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

Transferimi i pronësisë mbi kuotën objekt kontrate do të bëhet efektiv, me regjistrimin e kësaj kontrate në Regjistrin e Kuotave të Shoqërisë, si dhe në QKB Tiranë

NENI 4 - DEKLARIME DHE GARANCI

1. Shitësi deklaron dhe garanton se:
 - a) Është pronar ligjor dhe përfitues i vetëm i kuotave të përshkruara në këtë kontrate.
 - b) Kuotat objekt kontrate janë shlyer krejtësisht dhe janë të lira nga çdo lloj barre, pengu apo detyrimi tjetër dhe Shitësi ka të drejta të plota, pushtet dhe autoritet për shitje (transferim), në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.
2. Shitësi garanton Blerësin se në momentin e regjistrimit të kësaj Kontrate në regjistrin e kuotave të shoq. dhe në QKB:
 - a) Blerësi fiton titullin e pakthyesëm të pronësisë mbi këtë kuotë si dhe çdo të drejtë tjetër që lidhet me zotërimin;
 - b) Shitësi mbetet ortak pronar i kuotës në vlerë 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Në datën e ekzekutimit të kësaj kontrate Blerësit deklaron dhe garanton se njohin detyrimin për likjdimin e çmimit të blerjes në masën dhe në mënyrën e përcaktuar në këtë kontratë.

NENI 5 - SHPENZIMET DHE TAKSAT

Shpenzimet ligjore dhe noteriale që lidhen me këtë kontrate do të paguhen nga Blerësi, ndërsa detyrimet e tjera fiskale, në përputhje me parashikimet në legjislacionin në fuqi.

NENI 6 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Kontrate do të zgjidhen ndërmjet palëve me mirëkuptim dhe nëse nuk arrihet kjo, mosmarrëveshjet do të zgjidhen në rrugë gjyqësore, duke përcaktuar si gjykatë kompetente, Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

NENI 7 - TË NDRYSHME

1. Kjo Kontratë e shkruar përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve, për sa i përket objektit të kësaj kontrate dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, verbale apo të shkruara dhe të gjitha komunikimet e tjera të mëparshme ndërmjet palëve në lidhje me objektin në fjalë.
2. Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, çdo ndryshim i kësaj Kontrate mund të bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja Palët.
3. Te dyja palët janë dakord se afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate janë konfidenciale dhe nuk mund të zbulohen para një pale të tretë, përveç sa kërkohet ligjërisht sipas ligjit në fuqi.



Edmond DAKO

Studio Noteriale - Arnold Hajro

ADRESA : Blvd. "Gjergj Fishta", Pall. Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë, SHQIPËRI
Mob: +355 69 20 45 569; e-mail: hajro_arnold@yahoo.com

Adrian Hajro
Hajro



A2025053970035254526

4. Kjo Kontrate është përpiluar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha të nënshkruara nga palët, nga të cilat një kopje depozitohet për ruajtje në arkivin noterial, një kopje mbahet nga Shitësi, një kopje nga Blerësi, ndërsa kopja e fundit depozitohet për regjistrim praë QKB.

Për sa më sipër palët kishin rënë në marrëveshje para se të paraqiteshin tek noteri, konceptimi i këtij akti është bërë sipas vullnetit të palëve.

* * * * *

Unë, Noteri, mora autorizimin për përdorimin e të dhënave personale të palës/ palëve, duke garantuar se të dhënat e përdorura në këtë dokument, do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllim të redaktimit të këtij akti, në përputhje rigoroze me ligjin nr. 9887, dt. 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Ky akt, i përpiluar në 4 kopje origjinale (një prej të cilave ruhet në arkivin e noterit), ju lexua palëve, të cilët pasi e gjetën përmbajtjen e tij, konform kërkitimit dhe vullnetit të tyre të plotë, në prezencën time e pranuan aktin dhe e nënshkruan atë, dhe unë Noteri vërtetoj nënshkrimet, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

NËNSHKRIMET E PALËVE

PALA SHITËSE

Adrian HAJRO

(emër, mbiemër/ firmë)

PALA BLERËSE

Edmond DAKO

(emër, mbiemër/ firmë)

NOTER

Arnold HAJRO



Studio Noteriale - Arnold Hajro

ADRESA : Blvd. "Gjergj Fishta", Pall. Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë, SHQIPËRI
Mob: +355 69 20 45 569; e-mail: hajro_arnold@yahoo.com